



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 38

2000

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8680 datë 2.11.2000	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Selisë Qendrore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq”	1813
Ligj nr.8681 datë 2.11.2000	Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave	1819
Ligj nr.8684 datë 9.11.2000	Për disa shtesa në ligjin nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”	1825
Ligj nr.8685 datë 9.11.2000	Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë	1826
Ligj nr.8686 datë 9.11.2000	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 6.10.2000 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”	1828

Ligj nr.8687 datë 9.11.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën Europiane të Arbitrazhit”	1829
Ligj nr.8688 datë 9.11.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”	1836
Vendim i Kuvendit nr.461, datë 16.11.2000	Për miratimin e strukturës, të organikës dhe vendeve të punës të Sekretariatit Teknik, tabelës së pagave dhe buxhetit të Komisionit të Shërbimit Civil për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2000	1841
Vendim i Kuvendit nr.462, datë 16.11.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për lirin e zotit Ilir Gjoni nga detyra e ministrit të Mbrojtjes	1843
Vendim i Kuvendit nr.463, datë 16.11.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ismail Lleshi në detyrën e ministrit të Mbrojtjes	1844
Vendim i Kuvendit nr.464, datë 16.11.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për lirin e zotit Spartak Poçi nga detyra e ministrit të Rendit Publik	1844
Vendim i Kuvendit nr.465, datë 16.11.2000	Për miratimin e dekretit të presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Gjoni në detyrën e ministrit të Rendit Publik	1845
Vendim i Kuvendit nr.466, datë 16.11.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për lirin e zotit Ilir Zela nga detyra e ministrit të Punëve Publike	1845
Vendim i Kuvendit nr.467, datë 16.11.2000	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Spartak Poçi në detyrën e ministrit të Punëve Publike	1846
Vendim i KM nr.600, datë 17.11.2000	Për një shtesë në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore	1846
Vendim i KM nr.601, datë 17.11.2000	Për një shtesë në buxhetin e ministrisë së arsimit dhe shkencës, për dhënien e pagës së trembëdhjetë punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar	1847
Vendim i Gj.K nr.76	Me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1666, datë 16.04.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.2237, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.489, datë 26.03.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.17, datë 09.02.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë	1847
Vendim i Gj.K nr.77	Me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.138, datë 26.11.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë	

	1850
Vendim për shpallje të vdekur të Sadik Mustafës	1853
Ndreqje gabimesh	1854

L I G J
Nr. 8680, datë 2.11.2000

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË SELISË QENDRORE NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMITETIT NDËRKOMBËTAR TË KRYQIT TË
KUQ”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e Selisë Qendrore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2795, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

**MARRËVESHJE E SELISË QENDRORE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMITETIT NDËRKOMBËTAR TË KRYQIT TË KUQ**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë Qeveria) përfaqësuar nga Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, z.Pëllumb Xhufi dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (më poshtë KNKK), përfaqësuar nga Kryetari i Delegacionit në Republikën e Shqipërisë, z.Paul-Henri Morard.

DUKE VLERËSUAR punën e kryer nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, në dhënien e mbrojtjes dhe ndihmës pa bërë dallime, me pikësynim lehtësimin e vuajtjeve njerëzore,

DUKE PASUR PARASYSH interesin e Republikës së Shqipërisë dhe dëshirën e shprehur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq për të vendosur një delegacion që të kryejë detyrat humanitare që i janë besuar nga Konventat e Gjenevës të 1949-s dhe nga Protokollat - shtesë të 1977-s, në të cilët Republika e Shqipërisë është pjesëtare, si dhe nga Statutet e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmë Hënës së Kuqe,

RANË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1

Statusi i KNKK

Statusi i KNKK është i ngjashëm me atë të organizatave ndërqeveritare.

Neni 2
Personaliteti juridik

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njeh KNKK-së personalitetin juridik. KNKK-ja gëzon në territorin e Republikës së Shqipërisë të drejtën e plotë për të lidhur kontrata, për të fituar dhe zotëruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të ngrejë padi.

Neni 3
**Imuniteti KNKK-së,
pronave dhe i pasurive të tij**

KNKK, pronat dhe pasuritë e tij, kudo që të ndodhen dhe cilido qoftë mbajtësi i tyre, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesi ligjor dhe administrativ, përveç rasteve kur KNKK ka hequr dorë shprehimisht nga imuniteti i tij.

Neni 4
Padhunueshmëria e mjediseve pronës dhe pasurisë së KNKK

1. Mjediset e KNKK-së janë të padhunueshme. Prona dhe pasuritë e KNKK-së, kudo që të ndodhen dhe cilido qoftë mbajtësi i tyre, janë të imunizuara ndaj bastisjes, rekuizimit, konfiskimit, shpronësimit ose ndaj çdo lloj forme tjetër ndërhyrjeje, qofshin veprime ekzekutive, gjyqësore, administrative ose ligjore.

2. Mjediset e KNKK-së nuk duhet të përdoren për qëllime të papajtueshme me funksionet e tij zyrtare.

Neni 5
Padhunueshmëria e arkivave të KNKK

Arkivat e KNKK-së dhe, në përgjithësi, të gjithë dokumentet që i përkasin ose që mbahen prej tij, janë të padhunueshme, kudo që të ndodhen.

Neni 6
Komunikimet

1. KNKK është i lirë të përdorë për qëllime zyrtare dhe pa asnjë lloj ndërhyrje mjetet e komunikimit që ai do t'i konsiderojë si më të përshtatshëm për kontaktet e tij, veçanërisht me Selinë Qendrore të KNKK në Gjenevë, me organizmat e tjerë ndërkombëtarë që kanë lidhje me të, me departamentet qeveritare, si dhe me grupe të përbashkëta ose me persona privatë.

2. Në veçanti, KNKK ka të drejtë të vendosë në ambientet e tij pajisje të radiokomunikimit dhe të përdorë pajisje të lëvizshme brenda territorit shtetëror, dhe do të përjashtohet nga taksat e licensimit, si dhe nga të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera që lidhen me to. KNKK do të përdorë frekuencat që do t'i caktohen për këtë qëllim nga autoritetet kompetente shtetërore, në përputhje me Rezolutën Nr.10 (CAMR 1979) të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve.

3. Në të gjitha çështjet e lidhura me komunikimet zyrtare, KNKK do të gëzojë trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u bëhet organizatave ndërqeveritare përsa u përket përparësive, tarifave dhe taksave.

4. Delegacioni ka të drejtë të dërgojë dhe të marrë korrespondencën e tij nëpërmjet çantave postare të cilat do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje si dërgesat dhe çantat diplomatike, me kusht që këto çanta të mbajnë shenja të jashtme dhe të dukshme të karakterit të tyre, dhe që mund të përmbajnë vetëm dokumente ose artikuj të parashikuar për përdorim zyrtar.

Neni 7
Mjetet financiare të KNKK

1. KNKK ka të drejtë të mbajë monedhë kombëtare ose të huaj dhe kapital tjetër financiar dhe të operojë në llogari bankare në çfarëdolloj monedhe, pa iu nënshtruar ligjeve dhe rregulloreve që drejtojnë kontrollin e këmbimit dhe çështjet që kanë të bëjnë me të.

2. KNKK ka të drejtë të transferojë lirisht fonde në monedhë kombëtare ose të huaj, drejt shtetit, nga shteti dhe brenda tij, si dhe të konvertojë lirisht këto kapitale në monedha të tjera.

Neni 8
Përfshirja nga taksat

1. KNKK dhe kapitali, të ardhurat dhe prona e tij janë të përfshirura nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta, me përjashtim të atyre që përbëjnë detyrime për shërbimet me dobi publike.

2. KNKK është i përjashtuar nga të gjitha taksat jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë taksat mbi vlerën e shtuar) për blerje me shumicë të artikujve të paracaktuar për përdorim zyrtar dhe për blerjet e artikujve të parashikuar për programet e KNKK-së për asistencë brenda vendit ose në një vend tjetër. Qeveria do të marrë masat e duhura administrative për heqjen ose për kthimin e pagesave të bëra për taksa të tilla.

Neni 9
Përfshirja nga taksat doganore

1. KNKK do të jetë i përjashtuar nga taksat doganore ose nga çdo detyrim tjetër financiar i barasvlershëm, si dhe nga kufizimet apo ndalimet për import, eksport dhe tranzit nëpër Republikën e Shqipërisë, të artikujve (duke përfshirë botimet e KNKK-së dhe materialet audio-vizuale) për përdorim zyrtar ose artikujt e paracaktuar për programet e KNKK-së për asistencë në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër.

2. KNKK do t'i jepet e drejta e trafikut ajror dhe do të përjashtohet nga taksat e fluturimit dhe uljes në tokë për transportin e artikujve të ndihmës në Republikën e Shqipërisë ose duke kaluar tranzit nëpërmjet saj.

Neni 10
Statusi i anëtarëve të delegacionit

1. Anëtarët e huaj të delegacionit të KNKK dhe bashkëshortët e tyre, si dhe të tjerë që varen prej tyre, kanë të njëjtin statut me atë që u është dhënë anëtarëve të misionëve diplomatike.

2. Ata do të gëzojnë paprekshmëri personale dhe imunitet nga juridiksioni penal, civil dhe administrativ, në përputhje me nenet 21 dhe 31 të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961. Në veçanti ata nuk do të thirren si dëshmitarë.

3. Banesat, automjetet, dokumentet, dorëshkrimet private, si dhe të gjitha sendet e tjera personale të tyre janë të padhunueshme.

4. Anëtarët e huaj të delegacionit dhe familjet e tyre janë të përjashtuar nga të gjitha kufizimet e kontrollit të emigrimit, nga regjistrimi i të huajve dhe nga detyrimet e shërbimit kombëtar.

5. Me marrjen e detyrës, anëtarët e huaj të delegacionit kanë të drejtë të importojnë sendet e tyre personale duke qenë të përjashtuar nga taksat doganore. Çdo anëtar i huaj i delegacionit të KNKK, ka gjithashtu të drejtë të importojë automjetin e tij (ose asaj) personal, pa asnjë lloj takse apo detyrimi tjetër financiar. Ata gëzojnë të njëjtat përjashtime edhe gjatë largimit të tyre.

6. Anëtarët e huaj të delegacionit kanë të drejtë të shesin sendet e tyre personale në Republikën e Shqipërisë, me të njëjtat kushte si ato që u janë dhënë anëtarëve të misioneve diplomatike.

7. Në rast trazirash të brendshme ose konflikti ndërkombëtar, anëtarët e huaj të delegacionit, si dhe të afërmit e tyre, do të gëzojnë të njëjtat lehtësi për t'u riatdhesuar me ato që u garantohen stafeve diplomatike, në përputhje me vlefshmërinë e nenit 44 të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961.

8. Anëtarët e huaj të delegacionit përfitojnë të njëjtat privilegje si ato që u janë dhënë anëtarëve të misioneve diplomatike në lidhje me lehtësitë e shkëmbimit.

9. Anëtarët e huaj të delegacionit të KNKK janë të përjashtuar nga të gjitha taksat mbi rrogat dhe nga pagesat e tjera të dhëna nga KNKK ose të marra prej tyre jashtë Republikës së Shqipërisë në përgjithësi.

10. Në vazhdim të imuniteteve dhe privilegjeve të përmendura më lart, Shefi i delegacionit të KNKK dhe zëvendësi i tij/saj, dhe bashkëshortët e tyre, si dhe të tjerët që varen prej tyre, përfitojnë nga i njëjti statut që u është dhënë shëfave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Shqipërisë sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplommatike të 16 prillit 1961.

11. Anëtarët e delegacionit, të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë ose që janë me qëndrim të përhershëm në këtë vend nuk përfitojnë nga imunitetet, privilegjet dhe lehtësitë e përmendura në nenet e mësipërme 1-9, përveç imunitetit ndaj proceseve gjyqësore lidhur me veprimet e kryera prej tyre për përmbushjen e detyrave të tyre.

12. Delegacioni do të informojë autoritetet kompetente për hyrjet dhe daljet nga vendi, si dhe për titujt dhe funksionet e personelit që punon në Republikën e Shqipërisë.

13. Anëtarët e delegacionit angazhohen të respektojnë ligjet dhe rregulloret në fuqi të Republikës së Shqipërisë nga momenti i ardhjes në vend dhe mund të përfitojnë nga mbrojtja e tyre. Anëtarët e huaj të delegacionit nuk duhet të ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë veprimtari profesionale ose tregtare me qëllim përfitimi vetjak.

Neni 11

Përfaqësuesit e KNKK-së me mision të përkohshëm

Përfaqësuesit e KNKK-së me mision të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë përfitojnë nga privilegjet dhe imunitetet e përmendura në paragrafet 2, 3, 4, 7 dhe 8 të nenit 10.

Neni 12

Dokumenti i identitetit dhe emërimi në detyrë

1. Anëtarët e huaj të delegacionit dhe përfaqësuesit e KNKK-së me mision të përkohshëm do të mbajnë një dokument të quajtur "Dokument i identitetit dhe emërimit në detyrë" që vërteton identitetin e mbajtësit dhe statusin e tij/saj si anëtar i personelit të KNKK.

2. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë do ta pranojnë këtë dokument si një dokument të vlefshëm udhëtimi. Me paraqitjen nga ana e mbajtësit, ata do t'i lehtësojnë atij kalimin e kufijve ndërkombëtarë të Republikës së Shqipërisë dhe udhëtimin brenda vendit.

Neni 13

Bashkëpunimi me vendin pritës

1. KNKK do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet, me qëllim që të parandalojë çdo formë abuzimi me privilegjet, imunitetet dhe lehtësitë e parashikuara në këtë marrëveshje.

2. KNKK do të mund t'i heqë imunitetin çdonjërit prej anëtarëve të delegacionit të tij, në çdo rast kur, sipas mendimit të tij, ky imunitet pengon zbatimin e drejtësisë dhe kur heqja e këtij imunitetit nuk dëmton interesat e KNKK-së.

Neni 14

Interpretimi

Kjo marrëveshje do të interpretohet në përputhje me qëllimin e saj, e cila i jep KNKK-së të drejtën të marrë përsipër përgjegjësitë e tij, të përmbushë detyrat e tij dhe të realizojë programet e tij në mënyrë të plotë dhe efikase.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me anë të bisedimeve

1. Të gjitha çështjet e parashikuara nga kjo marrëveshje do të rregullohen në përputhje me dispozitat e Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961 ose rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj marrëveshjeje, që rrjedh nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet me bisedime ndërmjet palëve.

3. Palët do të kenë parasysh interesat kombëtarë të Republikës së Shqipërisë dhe interesat e KNKK që lidhen me veprimtaritë e tij. Ata do të përpiqen të bëjnë ç'është e mundur në mënyrë që mosmarrëveshja të zgjidhet me mirëbesim e drejtësi, si dhe me maturinë e domosdoshme për ruajtjen e marrëdhënieve të mira midis palëve.

Neni 16

Arbitrazhi

Nëse bisedimet e sipërpërmendura dështojnë mosmarrëveshjet do t'i nënshtrohen për vendim përfundimtar, një gjykatë arbitrazhi, të përbërë nga tre gjyqtarë, nga të cilët njëri do të jetë i emëruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, tjetri nga Kryetari i KNKK dhe i treti nga të dy palët ose, për mungesë marrëveshjeje, nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit do të jetë përfundimtar.

Neni 17

Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje

Kushtet e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen në çdo kohë me marrëveshje midis palëve.

Neni 18

Marrëveshjet plotësuese

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe KNKK-së mund të bien dakord për të hartuar marrëveshje të tjera si shtesë e kësaj marrëveshjeje.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje do të zbatohet përkohësisht pas nënshkrimit të saj dhe hyn në fuqi në datën në të cilën Qeveria e Republikës së Shqipërisë do ta njoftojë KNKK se procedura e parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë për ratifikimin e traktateve ndërkombëtare, është plotësuar.

Neni 20

Përfundimi

Kjo marrëveshje mund të përfundojë me kërkesën me shkrim të njëres prej palëve, me një paralajmërim minimal prej 6 muajsh, pas të cilit efekti i kësaj Marrëveshjeje merr fund.

Neni 21

Origjinalet dhe depozitimi

Kjo Marrëveshje do të përmbajë dy kopje origjinale të hartuara në shqip dhe anglisht, një nga secila do të depozitohen pranë Republikës së Shqipërisë dhe pranë KNKK.

Bërë në Tiranë më 13.7.2000

PËR QEVERINË E PËR KOMITETIN NDËRKOMBËTAR
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË KRYQIT TË KUQ

L I G J
Nr. 8681, datë 2.11.2000

**PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E DIGAVE DHE DAMBAVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të ndërtojë kuadrin bazë ligjor dhe institucional, nga i cili do të rrjedhë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që rregullon procesin e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave/dambave.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptimin e këtij ligji:

a) “Diga” është një objekt ndërtimor nivelngritës dhe ujëmbledhës formues, në përbërje të një kompleksi uJOR me disa qëllime si:

- furnizimi me ujë për prodhimin e energjisë elektrike;
- furnizimi me ujë i bujqësisë (ujitje, kultivim peshku e akuakulturë);
- furnizimi me ujë i industrisë dhe nevojave komunale;
- furnizimi me ujë të pijshëm të qendrave të banuara;
- mbrojtja nga përmbytjet e lumenjve;
- kërkesa turizmi e transporti uJOR të pjesshëm.

b) “Damba” është një objekt ndërtimor nivelngritës dhe depozitformues me materiale të ngurta, në përbërje të një kompleksi ose impianti industrial.

c) “Pjesë përbërëse” të digës/dambës janë trupi i digës (me mbushje ose prej betoni), elementet e papërshkrueshmërisë, nënobjektet e devijimit, zbrazjes, shkarkimit dhe marrjes së ujit për përdoruesit, konsumatorët.

ç) “Ujëmbledhës artificial” është kupa që mban ujë të mbyllur, si rrjedhojë e ndërtimit të një ose disa digave.

d) “Riparim” është punimi që kryhet në digë/dambë dhe pjesë të tjera përbërëse të saj, në rast dëmtimi ose vjetërimi të tyre.

dh) “Përmirësimi” është punimi që kryhet në digë/dambë për të shtuar aftësinë

ujëmbajtëse/depozituese, si dhe rritjen cilësore të mënyrës së shfrytëzimit.

e) “Prishje” është dëmtimi ose deformimi i digës/dambës në atë shkallë sa të mos mund të mbajë ujë ose materiale të ngurta.

ë) “Aksident” është çdo situatë që krijohet, dëmtim ose keqfunksionim në digë/dambë, pa arritur në “prishje”.

f) “Të tretë”, janë faktorët që ndodhen në pjesën e poshtme të digës/dambës.

g) “Siguria e digës/dambës”, është tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare, që garantojnë shfrytëzimin normal të objektit, jetëgjatësinë e tij dhe moscenimin e “të tretëve” që parashikohen në fazën e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.

Neni 3

Fusha e veprimit

Ky ligj ka fuqi vepruese në të gjitha digat/dambat, që ndërtohen të reja ose janë në shfrytëzim, të shtrira në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Lartësia e digës/dambës të jetë mbi 15 metra.

b) Lartësia e digës të jetë 10 deri 15 metra kur:

- vëllimi i ujit të grumbulluar është mbi 1 hm³ (një milionë m³) ujë;

- gjatësia e kurorës është mbi 500 metra.

c) Çdo digë/dambë tjetër, që nuk plotëson kushtet në pikat “a” dhe “b”, përbën rrezik për të “tretët”.

KREU II

ORGANET SHTETËRORE QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE NË FUSHËN E DIGAVE/DAMBAVE

Neni 4

A. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), si organ i Këshillit të Ministrave, ushtron kontrollin e shtetit për sigurinë e digave/dambave si vepra të një rëndësie të veçantë dhe përfaqëson shtetin shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD).

Për realizimin e detyrave KKDM-ja ndihmohet nga Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave si organ këshillimor i tij.

Detyrat kryesore të KKDM-së janë:

a) Mbështetja e përparimit teknik në konceptim, ndërtim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të digave/dambave, në interes të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

b) Plotësimi i detyrimeve teknike dhe financiare ndaj ICOLD-së.

c) Organizimi i këmbimit të të dhënave dhe të përvojës ndërmjet Komitetit Shqiptar dhe komiteteve të vendeve të tjera, ndërmjet specialistëve dhe organizatave brenda vendit dhe me analogët e tyre jashtë vendit.

ç) Npërmjet botimeve realizon propagandën teknike, sensibilizimin e organeve shtetërore dhe të publikut të gjerë për vlerat e shumanshme të digave/dambave, por edhe për pasojat shumë të rënda në vlerat ekonomike dhe në njerëz, në rastin e prishjes së tyre.

d) Në bashkëpunim me institucione dhe organizma të specializuar organizon dhe drejton përgatitjen e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik, që vepron për digat/dambat.

dh) Miraton projektidetë dhe projektzbatimet e digave të reja, si dhe projektet e “riparimit” dhe të “përmirësimit” të digave/dambave që janë në shfrytëzim.

e) Bën kontroll fizik dhe dokumentar, verifikues në digat/dambat gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre. Shfrytëzuesit e objekteve janë të detyruar t’u përgjigjen në kohë dhe me cilësi kërkesave të KKDM-së gjatë kontrollit.

ë) Njofton Këshillin e Ministrave për gjendjen e digave/dambave dhe jep mendim për ecurinë normale dhe përmirësimin në kohë të këtyre objekteve.

f) Miraton kriteret për dhënie licence të projektimit dhe të ndërtimit të digave e të dambave.

B. Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM), si zyrë ekzekutive e KKDM-së.

SKDM-ja, vepron në ministrinë përkatëse, që ndjek veprimtarinë kontrolluese të projektimit,

ndërtimit dhe shfrytëzimit të digave dhe dambave.

Ky Sekretariat ka të drejtë të ushtrojë kontroll në institucionet, që administrojnë digat dhe dambat, si dhe të përgatisë propozime të akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë.

Detyrat kryesore të SKDM-së janë:

- a) Përgatitja e materialeve që shqyrtohen në mbledhjet e KKDM-së.
- b) Ndjekja e zbatimit të vendimeve të marra nga KKDM-ja.
- c) Mbatja e letërkëmbimeve me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.
- ç) Krijimi i arkivës teknike me dokumentet që përcaktohen në rregullore.
- d) Administrimi i fondit të literaturës teknike që disponon KKDM-ja dhe organizimi i shpërndarjes të të dhënave pranë organizatave, ndërmarrjeve dhe individëve që kanë interes për digat dhe dambat.

dh) Përgatitja dhe botimi i “Buletinit teknik” të digave.

e) Organizimi i veprimtarive shkencore me specialistë vendas dhe të huaj.

ë) Mbledhja e të dhënave për digat/dambat dhe vërtetësimi i tyre, duke bërë edhe vizita pranë institucioneve administruese ose pranë objekteve në terren.

C. Inspektorati Teknik i Digave/dambave (ITD) është organ që ushtron kontroll gjatë ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes së digave. Inspektorati Teknik për digat dhe dambat është pjesë e strukturës së SKDM-së.

Struktura, numri i anëtarëve, pagat dhe shpenzimet që nevojiten për të përballuar veprimtarinë e KKDM-së, SKDM-së dhe ITD-së, si dhe mjediset e punës përcaktohen me vendime të Këshillit të Ministrave, të propozuara nga Ministria e Punëve Publike.

Shpenzimet dhe pagat që nevojiten për të mbuluar veprimtarinë e KKDM-së, SKDM-së dhe ITD-së përballohen nga Buxheti i Shtetit.

KREU III PROJEKTIMI I DIGËS/DAMBËS

Neni 5

Projektimi i digës/dambës

A. Projektideja përmban:

a) studimet topografike, gjeologjike, gjeologo-inxhinierike e hidrogeologjike të zonës së ndërtimit, të kupës së ujëmbledhësit etj.;

b) ndikimin në mjedisin natyror dhe shoqëror;

c) karakteristikat e valës që krijohet në luginën poshtë digës/dambës, në rastin kur:

- shkarkohet plota maksimale;

- bëhet shkarkim i sforcuar (plota plus zbrazja e detyruar e ujëmbledhësit);

- ndodh prishja e mundshme e digës;

ç) vizatimet e punës, llogaritjet, vlera e punimeve dhe e shpronësimeve;

d) vendosja e aparaturave të dëgjimit të digës/dambës;

dh) mënyra e ndërlidhjes dhe e mbrojtjes së objektit;

e) recensat përkatëse të projektidesë.

Projektidea hartohet në jo më pak se dy zgjidhje.

B. Projektzbatimi (ekzekutiv) përmban:

a) Vizatimet, llogaritjet, vlera e punimeve dhe shpronësimeve të zgjidhjes së pranuar.

b) Relacionet:

- relacionin teknik dhe argumentimin e zgjedhjes së tipit të pranuar të digës/dambës;

- relacionin gjeognostik;

- relacionin hidrologjik;

- relacionin me karakteristikat e materialeve për ndërtimin e digës/dambës;

- relacionin me përfundimet e provave të kryera mbi formacionin që shërben si bazament i objektit dhe nënobjekteve të digës/dambës;

- planin e alarmit, të evakuimit dhe të ndihmës për përballimin e pasojave që vijnë si rezultat i situatave të përshkruara në nenin 5 shkronja A/c

Neni 6
Ndërtimi i digës/dambës

a) Fillimi i punimeve të ndërtimit të digës/dambës bëhet vetëm pasi të jetë plotësuar dokumentacioni i nevojshëm i parashikuar në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, si dhe të këtij ligji.

b) Me përfundimin e punimeve bëhet kolaudimi i objektit, në përshtatje me kërkesat e ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Neni 7
Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja

a) Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e veprës fillon me vënien për herë të parë në ngarkesë të digës nëpërmjet mbushjes së ujëmbledhësit.

b) Në periudhën e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes së digës/dambës kryhet edhe riparimi e përmirësimi sipas kushteve specifike.

KREU IV
PRONËSIA DHE SHFRYTËZUESI I OBJEKTIT

Neni 8
Pronësia

a) Diga/damba dhe ujëmbledhësi janë prona shtetërore, publike ose private.

b) Pronar i digës/dambës mund të jetë: një person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 9
Shfrytëzuesi i objektit

Shfrytëzuesi i objektit (digës/dambës dhe ujëmbledhësit) mund të jetë:

- pronari (neni 8)
- përdoruesi
- koncensionari

Shfrytëzuesi është përgjegjësi kryesor për sigurinë e objektit dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme në digë/dambë.

Shfrytëzuesi i objektit:

a) shfrytëzon burimin ujor të krijuar nga diga dhe ujëmbledhësi, për qëllimin e përcaktuar në projekt. Për rastin e dambës shfrytëzon mundësinë depozituese të krijuar nga damba për mbajtjen e mbetjeve industriale dhe moslejimin e largimit të tyre në mënyrë të pakontrolluar;

b) mirëmban objektin sipas kërkesave teknike që dalin nga rregulloret dhe udhëzuesit, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe KKDM-ja;

c) mbulon të gjitha shpenzimet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin, përmirësimin dhe gjithë veprimtaritë që lidhen me sigurimin e digës/dambës dhe të të tretëve;

ç) kompenzon totalisht humbjet që pësojnë të tretët, kur ato e kanë origjinën nga diga/damba dhe

d) në rastin kur dëmet shkaktohen nga forca madhore, pamundësisht të parashikueshme në projekt, në kompensimin e humbjeve merr pjesë edhe shteti;

dh) informon dikasterin përkatës që mbulon destinacionin e digës/dambës, jo më pak se dy herë në vit, për sjelljen e objektit dhe çdo ngjarje që lidhet me sigurinë e tij.

Neni 10
Kontrolli i sigurisë së digës/dambës

A. Kontrolli i sigurisë së digës/dambës, pavarësisht nga pronësia, kryhet nga shteti nëpërmjet KKDM-së dhe ITD-së.

B. Kontrolli i sigurisë së digës/dambës ushtrohet gjatë projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes.

Ai synon:

- a) të verifikojë zbatimin e ligjshmërisë;
- b) të zbulojë të metat e mundshme në digë/dambë;
- c) të vlerësojë situatat e vështira që mbartin rreziqe për sigurinë e objektit;
- ç) sipas rastit, të rekomandojë masa për riparimin e mangësive të konstatuara, shmangien e situatave të vështira dhe të kërkojë në kohë realizimin e tyre.

C. Organet që ushtrojnë kontroll në diga/damba janë:

- a) dikasteri ose organi që mbulon qëllimin e objektit për të cilin është ndërtuar diga/damba;
- b) Inspektorati Teknik i Digave/dambave (ITD).

Ç. Dikasteri ose organi që mbulon destinacionin e objektit dhe Inspektorati Teknik, brenda muajit mars të çdo viti, njoftojnë KKDM-në për rezultatet e kontrollit të kryer nga ana e tyre. Në rastin e situatave të jashtëzakonshme të dhënat jepen menjëherë.

Neni 11
Sanksione

Përveç detyrimeve që përmbajnë këto dispozita, shkelje dhe kryerje të veprimeve të kundërligjshme të cilat përbëjnë kundërvajtje në fushën e digave/dambave dënohen me gjobë:

- për nenin 6 me shumën 500 000 lekë
- për nenet 5 dhe 9 me shumën 100 000 lekë.

Gjobat vendosen nga Kryetari i Inspektoratit Teknik të Digave/dambave.

Neni 12

Kundër vendimit të marrë nga Inspektorati Teknik i Digave/dambave mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve pranë KKDM-së, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve.

Procedurat për vënien e vjeljen e gjobave rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Gjobat paguhen në zyrën e financës së organit të kontrollit.

Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2796, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8684, datë 9.11.2000

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8455, DATË 4.2.1999 “PËR NJË TRAJTIM TË

VEÇANTË TË FAMILJEVE TË PILOTËVE QË HUMBASIN JETËN NË PËRMBUSHJE TË DETYRËS GJATË FLUTURIMIT”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit” bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në emërtimin e ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”, pas fjalës “...të pilotëve” shtohen fjalët “dhe të ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore”.

Neni 2

Në nenin 1 paragrafi i parë rreshti i parë, pas fjalëve “... të pilotit” shtohen fjalët “ose të pjesëtarëve të ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore”.

Neni 3

Në nenin 3 rreshti i parë, pas fjalëve “...në ngarkim të pilotit” shtohen fjalët “ose të pjesëtarëve të ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore” dhe, në rreshtin e fundit, pas fjalëve “Ministria e Mbrojtjes” shtohen fjalët “dhe Ministria e Shëndetësisë, për pilotët e njësisë së saj të helikopterëve dhe pjesëtarët e ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore.”

Neni 4

Në nenin 4 rreshti i parë, pas fjalëve “... të pilotëve” shtohen fjalët “ose të pjesëtarëve të ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore”.

Neni 5

Në nenin 5 rreshti i parë, pas togfjalëshit “Ministria e Mbrojtjes” shtohet “, Ministria e Shëndetësisë”.

Neni 6

Efektet e këtij ligji shtrihen edhe për familjet e pjesëtarëve të ekipit mjekësor dhe të pedagogëve të rënë në krye të detyrës në aksidentin ajror të Llogarasë në vitin 1989.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2799, datë 20.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8685, datë 9.11.2000

**PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA
NË NËNTOKË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Me termin **bazë e vlerësuar** do të kuptohet paga sipas së cilës janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore nga data 1.1.1994 e deri në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim.

Me termin **përfitim minimal** do të kuptohet masa mujore e përfitimit të caktuar në nivelin minimal, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me termin **periudhë sigurimi** do të kuptohen të gjitha periudhat e marrëdhënieve të punës për të cilat janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore.

Me termin **veprimtari ekonomike** do të kuptohet ushtrimi i çdo lloj veprimtarie në të cilën personat janë në marrëdhënie si të punësuar ose të vetëpunësuar, me përjashtim të atyre personave të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi.

Neni 2

Punonjësit që kanë punuar në miniera për një periudhë jo më pak se 11 vjet e gjysmë në nëntokë dhe kanë një periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet, në rastet kur nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike, trajtohen me përfitim.

Neni 3

Masa e përfitimit për këta punonjës do të jetë e barabartë me 60 për qind të bazës së vlerësuar. Në rastet kur për llogaritjen e bazës së vlerësuar mungojnë dokumentet, masa e përfitimit do të caktohet në nivelin e përfitimit minimal, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

E drejta e ushtrimit të kërkesës për përfitime nga ky ligj mund të ushtrohet nga subjektet që përfitojnë deri më datë 31.3.2001. Kjo kërkesë paraqitet pranë degëve të agjencive të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.

Neni 5

Përjashtohen nga përfitimet, sipas këtij ligji, personat të cilët përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimeve shoqërore.

Neni 6

Përfitimet nga ky ligj financohen nga Buxheti i Shtetit, ndërkohë detyrimet e prapambetura nga ndërmarrjet minierare ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore nuk përbëjnë pengesë për këtë përfitim.

Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kundrejt një pagese komisioni e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet përkatëse nënligjore në përputhje me këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2800, datë 20.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J **Nr.8686, datë 9.11.2000**

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.5, DATË 6.10.2000 **“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 6.10.2000 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Shpallur me dekretin nr.2801, datë 20.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

AKT NORMATIV **Nr. 5, datë 6.10.2000**

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në nenin 26, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë

përmbajtje:

“Për importimin e makinerive dhe të pajisjeve, të blera nga KESH, sh.a, zbatohet sistemi i shtyrjes së pagesës së TVSH-së. KESH sh.a, nuk paguan TVSH në doganë, në çastin e importimit të këtyre makinerive dhe pajisjeve. Në deklaratën mujore të TVSH-së, që paraqitet në degën e tatimeve, TVSH-ja e makinerive dhe e pajisjeve të importuara raportohet si detyrim dhe si e zbritshme.

Dogana merr një kopje të faturës së TVSH-së, për të mbyllur llogaritë kontabile të importimeve.”.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht në organet e informimit publik.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

L I G J
Nr. 8687, datë 9.11.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
“KONVENTËN EUROPIANE TË ARBITRAZHIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën Europiane të Arbitrazhit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2802, datë 20.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

KONVENTA EUROPIANE
MBI ARBITRAZHIN TREGTAR NDËRKOMBËTAR

Gjenevë, 21 prill 1961

Hyrë në fuqi më 7 janar 1964, në përputhje me nenin X, paragrafi i 8, me përjashtim të paragrafeve 3 deri në 7 të nenit IV, që kanë hyrë në fuqi më 18 tetor 1965 në bazë të paragrafit IV të shtojcës së Konventës.

Të nënshkruarit,

Të autorizuarit në mënyrë të rregullt,

Të mbledhur nën kujdesin e Komisionit Ekonomik për Europën të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Pasi konstatuan që më 10 qershor 1958 me mbarimin e Konferencës së Kombeve të Bashkuara

për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, nënshkruan në Nju-Jork një Konventë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit.

Duke dashur të kontribuojnë në zhvillimin e tre gtisë europiane, të mënjanoen sa të jetë e mundur disa vështirësi, të cilat mund të pengojnë organizimin dhe funksionimin e Arbitrazhit Tregtar Ndërkombëtar në marrëdhëniet midis personave fizikë ose juridikë të vendeve të ndryshme të Europës,

U muarrën vesh për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1

Fusha e zbatimit të Konventës

1. Kjo Konventë zbatohet :

a. për marrëveshjet e përfunduara të arbitrazhit që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshjeve e kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme;

b. për procedurat dhe vendimet e arbitrazhit, që bazohen në marrëveshjet e parashikuara në paragrafin 1,a më sipër.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente:

a. termi “Marrëveshje Arbitrazhi”, do të thotë qoftë klauzolë arbitrazhi në kontratë ose në marrëveshje arbitrazhi, kontratë ose marrëveshje arbitrazhi, që janë nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash, telegramesh ose në një komunikim me teleshkrues dhe në marrëdhëniet ndërmjet shteteve, ligjet e të cilëve nuk kërkojnë formën e shkruar për marrëveshjen e arbitrazhit, çdo marrëveshje e përfunduar në format e lejuara prej këtyre ligjeve;

b. termi “arbitrazh” do të thotë zgjidhja jo vetëm nga arbitrat e emëruar për çdo rast (arbitrazhi ad hoc),por edhe nga institucione të përhershme të arbitrazhit;

c. termi “seli” do të thotë vendndodhja e entit që ka përfunduar marrëveshjen e arbitrazhit.

Neni 2

Zotësia e personave juridikë të së drejtës publike për t’iu drejtuar arbitrazhit

1. Në rastet e parashikuara në nenin 1, paragrafi i parë i kësaj Konvente, personat juridikë, të cilët ligji që zbatohet për to, i cilëson si “persona juridikë të së drejtës publike”, kanë të drejtë të përfundojnë në mënyrë të vlefshme marrëveshje arbitrazhi.

2. Në rastin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Konventë, çdo shtet ka të drejtën të deklarojë se ai e kufizon këtë të drejtë me kushtet e parashikuara në deklaratën e vet.

Neni 3

E drejta e të huajve për të qënë arbitra

Të huajt mund të caktohen si arbitra në arbitrazhet e parashikuara nga kjo Konventë.

Neni 4

Organizimi i arbitrazhit

1. Palët në një marrëveshje arbitrazhi do të jenë të lirë t’ia nënshtrojnë marrëveshjet:

a. një institucioni të përhershëm arbitrazhi; në këtë rast, procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në përputhje me rregulloren e institucionit në fjalë;

b. një procedure arbitrazhi “ad hoc”; në këtë rast palët do të kenë ndër të tjera të drejtën që:

I. Të caktojnë arbitrat ose të vendosin mënyrën për caktimin e arbitrave në rastin e një mosmarrëveshjeje aktual;

II. të caktojnë vendin e arbitrazhit;

III. të vendosin procedurën që duhet të ndjekin arbitrat.

2. Kur palët kanë rënë dakord që t’ia nënshtrojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre një arbitrazhi “ad hoc” dhe kur benda 30 ditësh nga njoftimi i kërkesës për arbitrazh palës së paditur, njëra

nga palët nuk e ka caktuar arbitrin e vet, ky i fundit do të caktohet, përveç kur parashikohet ndryshe me kërkesën e palës tjetër nga kryetari i dhomës kompetente të tregtisë të atij vendi në të cilin pala fajtohet ka në çastin e paraqitjes së kërkesës për arbitrazh në selinë e vet të zakonshme apo qendrën e vet. Ky paragraf zbatohet gjithashtu për zëvendësimin e arbitrit/arbitrave të caktuar nga njëra palë ose kryetari i dhomës së tregtisë, që referohet më sipër.

3. Kur palët kanë rënë dakord t'ia nënshtrojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve një arbitrazhi “ad hoc”, me një ose me shumë arbitra dhe marrëveshja e arbitrazhit nuk përmban të dhëna për organizatën e arbitrazhit siç përmendet në paragrafin 1 të këtij neni, këto masa do të merren nga arbitri/arbitrat e caktuar, me përjashtim kur palët bien dakord dhe pa dëm për çështjen që referohet në paragrafin 2 më sipër. Kur palët nuk merren vesh për caktimin e arbitrit të vetëm ose kur arbitrat e caktuar nuk merren vesh për masat që duhet të merren, paditësi do të kërkojë për kryerjen e veprimeve të nevojshme, kur palët kanë rënë dakord për vendin e arbitrazhit, sipas zgjidhjes së Kryetarit të Dhomës së Tregtisë të vendit të arbitrazhit të rënë dakord ose kryetarit të dhomës kompetente të tregtisë të vendndodhjes së zakonshme ose qendrës së të paditurit në kohën e paraqitjes së kërkesës për arbitrazh. Në qoftë se palët nuk janë marrë vesh për vendin e arbitrazhit, paditësi mund t'i drejtohet, sipas zgjedhjes së tij, si kryetarit të dhomës kompetente të tregtisë ku i padituri ka selinë e vet të zakonshme ose qendrën e tij në momentin e paraqitjes së kërkesës për arbitrazh, ashtu edhe një komiteti të posaçëm, përbërja dhe funksionimi i të cilit janë përcaktuar në shtojcën e kësaj Konvente. Në qoftë se paditësi nuk i ushtron të drejtat që i njihen sipas këtij paragrafi, këto të drejta mund të ushtrohen nga i padituri ose nga arbitrat.

4. Kur angazhohet për një kërkesë, kryetari ose komiteti i posaçëm kanë të drejtë sipas nevojës:

- a. të caktojë arbitrin e vetëm, arbitrin drejtues, arbitrin;
- b. të zëvendësojë arbitrin/arbitrat e caktuar, sipas një procedure të ndryshme nga ajo që parashihet në paragrafin 2 të këtij neni;
- c. të përcaktojë vendin e arbitrazhit, me kusht që arbitri/arbitrat të mund të caktojnë ndonjë vend tjetër arbitrazhi;
- d. të përcaktojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose duke iu referuar rregullave ose statuteve të institucionit të përhershëm të arbitrazhit të rregullave të procedurës që do të ndiqen nga arbitri/arbitrat, me kusht që arbitrat të mos i kenë caktuar këto rregulla vetë në mungesë të një marrëveshje midis palëve.

5. Në qoftë se palët kanë rënë dakord për t'ia nënshtrojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre një institucioni të përhershëm arbitrazhi, pa e përcaktuar këtë institucion dhe nuk merren vesh për këtë përcaktim, paditësi mund të kërkojë caktimin e një institucioni të tillë në përputhje me procedurën që parashihet në paragrafin 3 të mësipërm.

6. Në qoftë se marrëveshja e arbitrazhit nuk përmban ndonjë përcaktim mbi llojin e arbitrazhit (arbitrazh me anë të një institucioni të përhershëm të arbitrazhit ose arbitrazh “ad hoc”), të cilit palët kanë rënë dakord t'ia nënshtrojnë mosmarrëveshjen e tyre dhe në qoftë se palët nuk bien dakord për këtë çështje, paditësi ka të drejtë të bëjë rekurs për këtë çështje sipas procedurës të parashikuar në paragrafin 3 të mësipërm. Kryetari i dhomës kompetente të tregtisë ose komiteti i posaçëm do të kenë të drejtë t'i drejtojnë palët tek një institucion i përhershëm i arbitrazhit, ose t'i kërkojnë palëve të caktojnë arbitrat e tyre brenda një afati që do t'u caktojë kryetari i dhomës kompetente të tregtisë ose komiteti i posaçëm dhe të bien dakord brenda të njëjtit afat për masat që janë të nevojshme për funksionimin e arbitrazhit. Në rastin e fundit do të zbatohen paragrafet 2,3 dhe 4 të këtij neni.

7. Në qoftë se brenda një afati prej 60 ditësh që nga çasti kur do t'i drejtohen me një nga kërkesat e përmendura nga paragrafet 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, Kryetari i Dhomës së Tregtisë, e cila është caktuar në bazë të njërit prej këtyre paragrafeve, nuk ka plotësuar një nga këto funksione, kërkuuesi do të ketë të drejtë t'i drejtohet Komitetit të Posaçëm për të bërë një gjë të tillë.

Neni 5

Kundërshtimi mbi kompetencën e arbitrazhit

1. Pala që ka qëllim të ngrejë kundërshtimin për kompetencën e arbitrit të bazuar në faktin që marrëveshja e arbitrazhit qoftë nuk ekzistonte ose ishte nul dhe e pavlefshme ose i ka kaluar afati do të bëjë një gjë të tillë gjatë procedurës së arbitrazhit jo më vonë se në çastin e dorëzimit të parashtesës së

tyre të kundërshtimit ose të mbrojtjes që lidhen me thelbin e çështjes; për ato që bazohen në faktin se një arbitër ka tejkaluar kushtet e tij të referimit kundërshtimi do të ngrihet gjatë procedurës së arbitrazhit sapo çështja për inkompetencën e arbitrit është ngritur gjatë procedurës së arbitrazhit kur vonesa në paraqitjen e kundërshtimit është pasojë e një shkaku, të cilin arbitri e konsideron të justifikueshëm, arbitri do të deklarojë kundërshtim të pranueshëm.

2. Kundërshtimet për kompetencën që parashihen në paragrafin 1 të mësipërm që nuk janë ngritur brenda afateve të caktuara nuk mund të hyjnë gjithashtu gjatë fazave të mëtejshme të procedurës së arbitrazhit, kur ato janë kundërshtime që i lihen gjykimit të vetëm të palëve sipas ligjit të zbatueshëm nga arbitri ose sipas procedurës së mëtejshme të gjykatës lidhur me thelbin ose zbatimin e vendimit kur këto kundërshtime i janë lënë gjykimit të palëve sipas rregullave të konfliktit të gjykatës së angazhuar për thelbin e çështjes ose zbatimin e vendimit. Vendimi i arbitrit për vonesën e ngritjes së kundërshtimit do të jetë sidoqoftë objekt i kontrollit gjyqësor.

3. Duke qenë objekt i kontrolleve gjyqësore të mëvonëshme, që parashihen nga lex fori kompetenca e të cilit kundërshtohet do të ketë të drejtën të vazhdojë të procedojë me arbitrazhin, të procedojë me kompetencën e tij dhe të vendosë për ekzistencën dhe vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit ose kontratës ku bën pjesë marrëveshja.

Neni 6

Juridiksioni i gjykatës

1. Kundërshtimi për juridiksionin e gjykatës i bërë para gjykatës, që angazhohet nga çdonjëra palë e marrëveshjes së arbitrazhit, mbi bazën e faktit të ekzistencës së një marrëveshjeje arbitrazhi do të paraqitet nga i padituri para ose në të njëjtën kohë me paraqitjen e mbrojtjes në themel të tij, gjë që varet nëse ligji i gjykatës së angazhuar e konsideron këtë kundërshtim si pjesë të procedurës ose të themelit.

2. Gjykata e shteteve kontraktuese, në marrjen e vendimit lidhur me ekzistencën ose vlefshmërinë e një marrëveshjeje arbitrazhi, do të shqyrtojë vlefshmërinë e një marrëveshjeje të tillë duke iu referuar zotësisë juridike të palëve, sipas ligjit të tyre të zbatueshëm, si dhe lidhur me çështje të tjera si vijon:

- a. sipas ligjit, të cilit palë i kanë nënshkruar marrëveshjen e tyre të arbitrazhit;
- b. kur mungon një përcaktim për këtë, sipas ligjit ku do të jepet vendimi;
- c. kur nuk tregohet ligji të cilit palët i kanë nënshkruar marrëveshjen dhe, kur në çastin kur çështja i është paraqitur gjykatës, vendi ku do të jepet vendim nuk është përcaktuar, sipas ligjit kompetent në bazë të rregullave të konfliktit të gjykatës të angazhuar për mosmarrëveshjen.

Gjykata, mundet, gjithashtu, të refuzojë njohjen e marrëveshjes së arbitrazhit në rast se sipas ligjit të vendit të tyre, mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet nga arbitrazhi.

3. Kur ndonjë nga palët në një marrëveshje arbitrazhi ka filluar një procedurë arbitrazhi, para se t'i drejtohet gjykatës, gjykata e shteteve kontraktuese që për rrjedhojë do të kërkojnë të trajtojnë të njëjtën çështje ndërmjet të njëjtave palë ose për rastin, kur marrëveshja e arbitrazhit nuk ekziston ose ishte nul dhe e pavlefshme ose i ka kaluar afati, do të qëndrojë në kompetencën e arbitrit deri në dhënien e vendimit të arbitrazhit, me përjashtim kur ka arsye të drejta dhe thelbësore për të kundërtën.

4. Një kërkesë për masa të përkohëshme ose masa sigurimi, që i është drejtuar një autoriteti gjyqësor, nuk mund të konsiderohet si e papajtueshme me marrëveshjen e arbitrazhit, as edhe si një shtrim i thelbit të çështjes në gjykatë.

Neni 7

Ligji i zbatueshëm

1. Palët do të përcaktojnë lirisht me marrëveshje ligjin, që do të zbatohet nga arbitrat lidhur me themelin e mosmarrëveshjes. Në rast të një përcaktimi të tillë nga palët, arbitrat do të zbatojnë ligjin e përshtatshëm në bazë të rregullave të konfliktit që arbitrat i konsiderojnë të përshtatshme për t'u zbatuar. Në të dy rastet arbitrat do të mbajnë parasysh dispozitat e kontratës, si edhe zakonet e tregtisë.

2. Arbitrat do të veprojnë si “ndërmjetës për mirkuptim” në rast se palët vendosin kështu edhe

në qoftë se ata mund ta bëjnë këtë në bazë të ligjit të zbatueshëm për arbitrazhin.

Neni 8

Arsyetimi i vendimit

Prezumohet se palët kanë rënë dakord, që vendimi i arbitrazhit të arsyetohet, përveç kur:

a. palët kanë deklaruar shprehimisht se vendimi nuk do të arsyetohet ose

b. ato i janë nënshtruar një procedure arbitrazhi sipas së cilës nuk është e zakonshme të përdoret arsyetim vendimi, me kusht që në këtë rast asnjë nga palët nuk kërkon që vendimi të jetë i arsyetuar para mbarimit të seancës ose, po të mos ketë pasur seancë para përpilimit të vendimit.

Neni 9

Anulimi i vendimit të arbitrazhit

1. Anulimi një njërin shtet kontraktues i një vendimi të arbitrazhit, që është parashikuar nga kjo Konventë, do të përbëjë vetëm një bazë refuzimi të njohjes ose të zbatimit në një shtet tjetër kontraktues, kur ku anulim është bërë në një shtet në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit vendimi është marrë për një nga rastet e mëposhtme:

a. palët në marrëveshjen e arbitrazhit ishin sipas ligjit të zbatueshëm të tyre, në pazotësi për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, që palët i janë nënshtruar ose, në mungesë të përcaktimit sipas ligjit të vendit ku është marrë vendimi ose,

b. pala që kërkon anulimin e vendimit nuk është informuar rregullisht me caktimin e arbitrit ose me procedurën e arbitrazhit, ose ajo nuk ka pasur zotësi të paraqesë rastin e saj ose,

c. vendimi ka lidhje me një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose përmban vendime për çështjen, që e kalojnë atë që i është nënshtruar arbitrazhit me kusht, që në qoftë se vendimet për çështjet që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i nënshtrohen, ajo pjesë e vendimit të arbitrazhit që përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit nuk do të anulohet;

d. firmimi i gjykatës së arbitrazhit ose i procedurës së arbitrazhit nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjen dhe kur mungon marrëveshja, me dispozitat e nenit 4 të kësaj Konvente.

2. Në marrëdhëniet midis shteteve kontraktuese, që janë palë në Konventën e Nju Jorkut “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, të datës 10 Qershor 1958, paragrafi 1 i këtij neni kufizon zbatimin e nenit 5 (1) (e) të Konventës së Nju Jorkut vetëm për rastet e anulimit sipas paragrafit 1 më sipër.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin ose aderim për vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe vendet e pranuar në Komisionin me të drejtë konsultative sipas paragrafit 8 të termave të referencës të këtij Komisioni.

2. Këto vende mund të marrin pjesë në disa aktivitete të komisionit Ekonomik për Europën sipas paragrafit 11 të termave të referencës së këtij Komisioni, mund të bëhen palë kontraktuese të kësaj Konvente, duke aderuar në të pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Konventa duhet të jetë e hapur për nënshkrim deri në datën 31 dhjetor 1961 inkluzivisht. Pas kësaj date do të qëndrojë e hapur për aderim.

4. Kjo Konventë do të ratifikohet.

5. Ratifikimi ose aderimi do të kryhet me anë të depozitimit të një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

6. Në firmosjen, ratifikimin ose aderimin në këtë Konventë palët kontraktuese do t'i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara listën e Dhomave të Tregtisë ose të institucioneve të tjera të vendit të tyre, të cilat do të ushtrojnë funksionet që i jepen sipas nenit IV, të kësaj Konvente kryetarëve të dhomave kompetente të tregtisë.

7. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të prekin vlefshmërinë e marrëveshjeve shumë palëshe ose dy palëshe, që janë përfunduar nga shtetet kontraktuese për arbitrazhin.

8. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pasi 5 nga vendet, që referohen në paragrafin 1 të mësipërm do të kenë depozituar instrumentat e tyre të ratifikimit ose të aderimit. Për çdo vend që ratifikon ose aderon në të më vonë, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pasi vendi në fjalë ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose të aderimit.

9. Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftimit për denoncim.

10. Në qoftë se pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, numri i palëve kontraktuese reduktohet si rezultat i denoncimeve në më pak se 5, Konventa do të pushojë së qeni në fuqi nga data kur denoncimi i fundit ka hyrë në fuqi.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i njoftojë vendet që përmenden në paragrafin 1, si dhe vendet që janë bërë palë kontraktuese sipas paragrafit 2 më sipër për:

- a. deklaratat e bëra në bazë të nenit 2, paragrafi 1;
- b. ratifikimet dhe aderimet në bazë të paragrafeve 1 dhe 2 më sipër;
- c. komunikimin e marrë sipas paragrafit 6 më sipër;
- d. datat e hyrjes në fuqi të Konventës sipas paragrafit 8 më sipër;
- e. denoncimet sipas paragrafit 9 më sipër;
- f. shfuqizimin e kësaj Konvente sipas paragrafit 10 më sipër.

12. Pas datës 31 dhjetor 1961 origjinali i kësaj Konvente do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do të transmetojë kopjet e vërtetuara seiclit prej vendeve të përmendur në paragrafet 1 dhe 2 më sipër.

Për të vërtetuar sa më sipër, të nënshkruarit që janë autorizuar rregullisht, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë më 21 Prill 1961, në një ekzemplar të vetëm në gjuhët frënge, angleze dhe ruse, duke pasur të tre tekstet vlerë të barabartë.

L I G J
Nr. 8688, datë 9.11.2000

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR NJOHJEN
DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2803, datë 20.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

KONVENTË PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT

Nju Jork, 10 qershor 1958
Hyrë në fuqi: më 7 qershor 1959

Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizike ose juridikë. Ajo zbatohet gjithashtu për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet dhe ekzekutimi i tyre.

2. Termi “vendime të arbitrazhit” do të përfshijë jo vetëm vendimet që kanë dhënë arbitrat e emëruar për çdo rast, por gjithashtu edhe ato që kanë dhënë organet e përhershme të arbitrazhit, të cilave iu janë nënshtruar palët.

3. Në momentin kur do të nënshkruhet, ratifikohet ose do të aderohet në këtë Konventë, ose do të njoftohet zgjatja sipas nenit 10, çdo shtet mundet, në bazë reciprociteti, të deklarojë se do të zbatojë konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, që janë dhënë vetëm në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Mund të deklarojë gjithashtu se do të zbatohet Konventa vetëm për mosmarrëveshjet e lindura nga marrëdhëniet juridike, kontraktorë ose jokontraktorë, të cilat konsiderohen si marrëdhënie tregtare nga legjislacioni kombëtar i shtetit që bën këtë deklaratë.

Neni 2

1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t’ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi.

2. Termi “marrëveshje e shkruar” do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh.

3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jooperative ose e pamundur për t’u zbatuar.

Neni 3

Secili shtet kontraktues do të njohë vendimet e arbitrazhit si vendime, që i lidhin ato dhe do t’i zbatojnë ato në përputhje me rregullat e procedurës në territorin ku vendimi është mbështetur, sipas kushteve të përcaktuara në nenet vijuese. Nuk do të imponohen në thelb me shumë kushte pagese ose shpenzime e pagesa më të larta për njohjen ose zbatimin e vendimeve të arbitrazhit, për të cilat zbatohet kjo Konventë nga ato që imponohen për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në vendin e tij.

Neni 4

1. Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit siç përmendet në nenin e mësipërm, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën sa vijon:

a. origjinalin e vendimit, të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur;
b. origjinalin e konventës së parashikuar në nenin 2 ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur.

2. Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit ku jepet vendimi, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë një

përkthim të këtyre dokumenteve në ato gjuhë. Përkthimi duhet vërtetuar nga një përkthyes zyrtar, ose një përkthyes i betuar, ose nga një agjent diplomatik apo konsullor.

Neni 5

1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që:

a. palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi ose

b. palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj, ose

c. vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose nuk hyn në klauzolën mbi arbitrazhin ose përmban vendime për çështjet që kalojnë fushën, që i nënshtrohet arbitrazhit; megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i janë nënshtruar, ajo pjesë e vendimit e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet; ose

d. përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose mungon një marrëveshje e tillë, nuk është në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar; ose

e. vendimi nuk ka marrë formën përfundimtare për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit është dhënë vendimi.

2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi konstaton se:

a. objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi, ose

b. njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi.

Neni 6

Në qoftë se kërkesa për anulimin ose pezullimin e vendimit është bërë pranë një organi kompetent në bazë të nenit 5 (1) (e), organi në të cilin kërkohet mbështetja, në rast se e konsideron me vend, e shtyn vendimin për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, dhe mundet gjithashtu, që me kërkesën e palës që kërkon ekzekutimin e vendimit të urdhërojë palën tjetër të japë garancira të përshtatshme.

Neni 7

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk prekin vlefshmërinë e marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe, që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit që kanë hyrë në fuqi midis shteteve kontraktuese dhe as i heq të drejtën ndonjë pale tjetër të interesuar për të përfituar nga ndonjë vendim arbitrazhi në mënyrën, si dhe përsa parashikohet nga ligji ose traktetet e vendit ku kërkohet të jepet një vendim i tillë.

2. Protokolli i Gjenevës për klauzolat e arbitrazhit i vitit 1923 dhe Konventa e Gjenevës për ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit e vitit 1927 do të pushojë efektin e tyre ndërmjet shteteve kontraktuese, që nga dita që ata lidhen, dhe në masën që ato lidhen me këtë konventë.

Neni 8

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur deri me datën 31 dhjetor 1958 për nënshkrimin në emër të çdo anëtari të Kombeve të Bashkuara, dhe gjithashtu në emër të ndonjë shteti tjetër, i cili është, ose bëhet më vonë anëtar i ndonjë agjencie të specializuar të Kombeve të Bashkuara ose është, ose bëhet më vonë pjesë e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose ndonjë shtet tjetër, të cilit i është adresuar një ftesë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

2. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë

Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 9

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim për të gjitha shtetet e parashikuar në nenin 8.
2. Aderimi do të bëhet duke depozituar një instrument të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

1. Çdo shtet mundet, në çastin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, të deklarojë se kjo Konventë do të shtrihet deri tek të gjitha ose ndonjë nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare për të cilat është përgjegjës. Një deklaratë e tillë do të ketë efekt kur Konventa do të hyjë në fuqi për shtetet në fjalë.
2. Më pas, në çdo kohë një shtrirje e tillë do të bëhet me njoftimin që i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe do të ketë efekt nga dita e 90-të pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, ose nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin në fjalë, që është dhe afati i fundit.
3. Përsa u përket atyre territoreve tek të cilat kjo Konventë nuk shtrihet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet në fjalë do të konsiderojë mundësinë e marrjes së hapave të domosdoshme me qëllim që të shtrijë zbatimin e Konventës në ato territore, subjekte ku është e domosdoshme për arsye kushtetuese pëlqimi i qeverive të këtyre territoreve.

Neni 11

1. Në rastin e një shteti federativ ose jounitar, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:
 - a. Për sa u përket neneve të kësaj Konvente, që hyjnë në juridiksionin ligjor të autoriteteve federative, detyrimet e qeverisë federale do të jenë të njëjta me ato të shteteve kontraktuese, që nuk janë shtete federative;
 - b. për sa i takon neneve të kësaj Konvente, që hyjnë në juridiksionin ligjor të shteteve ose provincave përbërëse, që, në bazë të sistemit kushtetues të federatës, nuk janë të detyruara të ndërmarrin masa legislative, qeveria federale do t'ua bëjë të njohur sa më parë, dhe me mendimin e vet të favorshëm, autoriteteve kompetente të shteteve ose provincave përbërëse nenet në fjalë;
 - c. çdo shtet federativ, që është palë në këtë Konventë, do të paraqesë, me kërkesën e çdo shteti tjetër kontraktues që do t'i transmetohet nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve, një deklaratë mbi ligjin dhe praktikën e federatës e njësive të saj përbërëse lidhur me ndonjë dispozite të veçantë të kësaj Konvente, duke treguar shtrirjen e efektit, që i është dhënë kësaj dispozite nga ndonjë veprim ligjor ose ndonjë veprim tjetër.

Neni 12

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së dorëzimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose aderimit.
2. Për secilin nga shtetet që do të ratifikojnë Konventën ose që do të aderojnë në të pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose të aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga ana e këtij shteti të instrumentit të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 13

1. Çdo shtet kontraktues mund të denoncojë këtë Konventë, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të sjellë efekt një vit pas datës kur Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do të ketë marrë njoftim.
2. Çdo shtet, cili ka bërë një deklaratë ose një njoftim sipas nenit 10, mundet në çdo kohë më vonë të deklarojë me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se Konventa do të pushojë së zbatuari në territorin në fjalë një vit pas datës në të cilën Sekretari i

Përgjithshëm do të ketë marrë njoftim.

3. Kjo Konventë do të vazhdojë të zbatohet për vendimet e arbitrazhit për të cilat ka qenë filluar një procedurë njohjeje ose ekzekutimi para hyrjes në fuqi të denoncimit.

Neni 14

Një shtet kontraktues nuk ka të drejtë të përfitojë nga kjo Konventë kundër shteteve të tjera kontraktuese vetëm në masën në të cilën ai është edhe vetë i detyruar ta zbatojë këtë Konventë.

Neni 15

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'u njoftojë të gjitha shteteve të parashikuara në nenin 8 sa vijon:

- i. nënshkrimet dhe ratifikimet e parashikuara në nenin 8;
- ii. aderimet në bazë të nenit 9;
- iii. deklaratat dhe njoftimet e parashikuara në nenet 1, 10 dhe 11;
- iv. datën kur do të hyjë në fuqi kjo Konventë, në zbatim të nenit 12;
- v. denoncimet dhe njoftimet në bazë të nenit 13.

Neni 16

1. Kjo Konventë, tekstet e së cilës kanë të njëjtën vlerë në gjuhën angleze, kineze, spanjolle, franceze dhe ruse, do të depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të t'i transmetojë një kopje të vërtetuar të kësaj Konvente shteteve të parashikuara në nenin 8.

V E N D I M

Nr. 461, datë 16.11.2000

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE VENDEVE TË PUNËS TË SEKRETARIATIT TEKNIK, TABELËS SË PAGAVE DHE BUXHETIT TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2000

Në mbështetje të nenit 5 pika 9 dhe pika 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", si dhe të neneve 88 e 92 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Miratohet struktura, organika dhe vendet e punës për Sekretariatin Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil (prej 28 vetësh), sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Miratohet tabela e pagave të punonjësve të Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Miratohet buxheti i gjashtëmujorit të dytë të vitit 2000 për Komisionin e Shërbimit Civil dhe Sekretariatin Teknik të tij (prej 18 milionë lekë), si vijon:

Artikulli 01 (paga)	3.400.000	lekë
Artikulli 02 (sigurime shoqërore)	500.000	lekë
Artikulli 03 (shpenzime operative)	4.100.000	lekë
Artikulli 05 (investime)	10.000.000	lekë

nga këto:

- Pajisje	4.000.000	lekë
- Rikonstruksione	1.000.000	lekë
- Autovetura	5.000.000	lekë

IV. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të sigurojë burimet financiare, për të përballuar shpenzimet e buxhetit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000 për Komisionin e Shërbimit Civil dhe Sekretariatit Teknik të tij.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

TABELA NR.1
ORGANIKA E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL DHE E SEKRETARIATIT TEKNIK

Nr	Emërtimi	Numri i personave
I	<i>Komisioni i Shërbimit Civil</i>	5
	Kryetar	1
	Anëtar	4
II	<i>Kabineti</i>	2
	Shefi i Kabinetit dhe Zëdhënësi i Komisionit	1
	Sekretare e Kryetarit	1
III	<i>Sekretar i Përgjithshëm</i>	1
IV	<i>Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Ankesave</i>	7
	Drejtor	1
	* Sektori i Administratës Qendrore	3
	Inspektor, këshilltar	3
	* Sektori i Institucioneve të Pavarura	3
	Inspektor, këshilltar	3
V	<i>Drejtoria e Personel Organizimit dhe e Shërbimeve</i>	13
	Drejtor	1
	* Sektori i Financës	2
	Shef sektori	1
	Specialist Ekonomist	1
	* Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë	1
	Shef Sektori	1
	* Sektori i Administratës	9
	Shef Sektori	1
	Zyra e Sekretari – Arkivit	
	Specialist arkivi-protokolli	1
	Specialist personeli	1
	Zyra e shërbimeve	
	Shofer	5
	Punëtor pastrimi	1

TABELA NR.2
TABELA E PAGAVE TË SEKRETARIATIT TEKNIK TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi i pagës
-----	----------	---------------------

1	Kryetari	A6
2	Anëtarë	A8
3	Shefi i Kabinetit dhe Zëdhënësi i Komisionit	B2
4	Sekretare e Kryetarit	C3
5	Sekretari i Përgjithshëm	A12
6	Drejtori i Personel-Organizimit dhe Shërbimeve dhe Drejtori i Mbikëqyrjes dhe Ankesave	B1
7	Inspektor, këshilltar	B3
8	Shef Sektori i Administratës; Shef Sektori i Financës; Shef Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë	B4
9	Specialist, ekonomist, specialist personeli	C2
10	Specialist arkiv-protokoll	C3
11	Shofer	IV
12	Punëtor pastrimi	III

V E N D I M
Nr. 462, datë 16.11.2000

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E
ZOTIT ILIR GJONI NGA DETYRA E MINISTRIT TË MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti nr.2781, datë 8.11.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Ilir Gjoni nga detyra e Ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 463, datë 16.11.2000

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E
ZOTIT ISMAIL LLESHI NË DETYRËN E MINISTRIT TË MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti nr.2782, datë 8.11.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ismail Lleshi në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 464, datë 16.11.2000

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E
ZOTIT SPARTAK POÇI NGA DETYRA E MINISTRIT TË RENDIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2783, datë 8.11.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Spartak Poçi nga detyra e Ministrit të Rendit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 465, datë 16.11.2000

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E
ZOTIT ILIR GJONI NË DETYRËN E MINISTRIT TË RENDIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti nr.2784, datë 8.11.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Gjoni në detyrën e Ministrit të Rendit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 466, datë 16.11.2000

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E
ZOTIT ILIR ZELA NGA DETYRA E MINISTRIT TË PUNËVE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti nr.2785, datë 8.11.2000 i Presidentit të Republikës për lirim të zotit Ilir Zela nga detyra e Ministrit të Punëve Publike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 467, datë 16.11.2000

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT SPARTAK POÇI NË DETYRËN E MINISTRIT TË PUNËVE PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti nr.2786, datë 8.11.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Spartak Poçi në detyrën e Ministrit të Punëve Publike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 600, datë 17.11.2000

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.529, DATË 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE QË ZOTËROHEN NGA SHETI, TË SHOQËRIVE TREGTARE”, NDRYSHUAR ME AKTE TË TJERA LIGJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” dhe të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.529, datë 21.8.1998, ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave në kapitullin XI, pas pikës 3, shtohet pika 3.1. me këtë përmbajtje:

“3.1. Në rastet kur blerësi kërkon që të bëhet auditim ndërkombëtar, për gjendjen e shoqërisë, afati i mbylljes së kontratës shtyhet 45 ditë të tjera.

Ky afat aplikohet edhe për kontratat të cilat janë në proces negociimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 601, datë 17.11.2000

**PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR
DHËNIEN E PAGËS SË TREMBËDHJETË PUNONJËSVE MËSIMORË TË SISTEMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8467, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar t’u jepet në fund të vitit, paga e trembëdhjetë.
 2. Një pjesë e kësaj page mund t’u jepet me mbarimin e vitit shkollor.
 3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për zbatimin e këtij vendimi, i shtohet, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, një fond prej 55 000 000 (pesëdhjetepesë milionë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “
Kujtim Puto,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalice, më datën 13.10.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.66 Akti që i përket:

KËRKUES: SKËNDER ROQI
SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, PRANË BASHKISË
TIRANË, i përfaqësuar nga avokat Kujtim Bara, me autorizim.

ISLAM, YLLI, FATOS, GEZIM, DYLL DHE SANIJE KADESHA, të përfaqësuar nga Islam
Kadesha.

O B J E K T I

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1666, datë 16.04.1997 të Gjykatës së Rrethit
Tiranë; nr.2237, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.489, datë 26.03.1998 të kolegjit civil
të Gjykatës së Lartë dhe nr.17, datë 09.02.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtuar se vendimet gjyqësore të të gjitha instancave janë rrjedhojë e një
procesi jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 paragrafi i parë i Kushtetutës dhe konkretisht
përmend këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Kundër gjyqtarës që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë, ka paraqitur ankesë për mungesë
objektiviteti, por ajo, megjithë porosinë e kryetarit, nuk e ka pranuar ankesën për të vepruar konformë
nenit 74 të Kodit të Procedurës Civile që të vendoste pezullimin e gjykimit gjersa të shqyrtohej çështja
e përjashtimit të saj nga Gjykata e Apelit;

- Është nxjerrë jashtë nga seanca gjyqësore e datës 15.04.1997 dhe ky fakt nuk gjen pasqyrim
në procesverbalin e seancës. Gjykimi i çështjes ka vazhduar dhe ka përfunduar më datën 16.04.1997
në mungesë të tij me pretekstin se ka pasur dijeni për datën e zhvillimit të gjykimit. Në këtë mënyrë
janë shkelur rregullat procedurale si dhe nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit;

- Gjykata, derisa pranon se ka qenë në dijeni të datës së gjykimit, sipas nenit 179 të Kodit të
Procedurës Civile, duhej të pushonte gjykimin e çështjes për mosparaqitje dhe jo të rrëzonte padinë;

- Në Gjykatën e Apelit dhe në kolegjin civil të Gjykatës së Lartë, përveç zgjidhjes së padrejtë
të bërë nga gjykata, ai ka parashtuar edhe veprimet e parregullta e antiligjore të gjyqtarës së shkallës
së parë, por nuk u morën në konsideratë prej tyre. Gjykata e Apelit, sipas nenit 465 paragrafi i dytë i
Kodit të Procedurës Civile, duhej të përsëriste tërësisht gjykimin dhe jo të mbështetej në aktet e
gjykatës së rrethit, të cilat janë të pavlefshme për shkak të shkeljeve të lejuara në këtë gjykatë. Në
rekursin drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka parashtuar kundërshtimet lidhur me
aktin e ekspertimit përsa i përket përlllogaritjeve të vlerës së punimeve të kryera në raport me vlerën e
banesës së vjetër dhe vlerës së truallit, por Kolegji Seleksionues nuk i vlerësoi këto pretendime.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e pronarëve që
kërkoi rrëzimin e kërkesës, përfaqësuesin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që e la
çështjen në çmim të gjykatës dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Skënder Roqi që nga viti 1989 banon si qiramarrës në një banesë shtetërore në të
cilën gjatë vitit 1990, me shpenzimet e veta, ka bërë disa shtesa si një korridor, kuzhinë, aneks, etj. Me
vendimin nr.314, datë 11.04.1994 të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave pranë
Bashkisë Tiranë, kjo pronë i kthehet trashëgimtarëve të Xhemal Kadeshës, të cilët, në bazë të vendimit
të komisionit e kanë kaluar në pronësinë e tyre të gjithë ndërtesën, përfshirë edhe shtesat e bëra nga
kërkuesi. Në vendimin e Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, theksohet se raporti i
vlerës së shtesave ndaj vlerës së plotë të objektit është 11.7 %, prandaj prona i kthehet ish-pronarit pa
kundërshtpërblim, konformë nenit 13 të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993. Për këtë shkak kërkuesi, si
qiramarrës që ka interes për çështjen i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Tiranë duke kërkuar
anullimin e kësaj pjese të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me
argumentin se vlera e shpenzimeve për shtesat e bëra në ndërtesë është mbi 60 %. Gjykata e Rrethit
Tiranë me vendimin nr.1666, datë 16.04.1997 ka rrëzuar padinë.

Kundër vendimit kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë duke parashtruar se ndërtimet i ka kryer me shpenzimet e veta dhe këto janë më të mëdha nga sa ka pranuar gjykata e rrethit. Njëkohësisht në ankimin e tij ai ka bërë prezent edhe pretendimin se është nxjerrë jashtë nga seanca dhe gjykimi i çështjes është zhvilluar në mungesë të tij pa dijeninë e kërkuesit, ndonëse me anë të një ankese drejtuar kryetarit të gjykatës kishte kërkuar që çështja të gjykohej nga një gjyqtar tjetër. Gjykata e Apelit Tiranë, me kërkesën e vet kërkuesit e ka gjykuar çështjen në fakt dhe pas shtatë seancave gjyqësore të, më datën 08.10.1997 ka dhënë vendimin e saj, duke pranuar pjesërisht padinë dhe ndryshuar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave lidhur me vlerën e shpenzimeve nga 11.7 % që kishte vendosur Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në 37 %. Në këto seanca janë administruar dokumentet dhe, përveç shpjegimeve të palëve, ka dhënë sqarime rreth aktit të ekspertimit ekspertja, e cila ka paraqitur edhe një shtojcë të aktit të ekspertimit në përgjigje të pyetjeve të ngritura nga kërkuesi. Në këto rrethana nuk qëndron pretendimi i ngritur nga kërkuesi se Gjykata e Apelit Tiranë është mbështetur në aktet e gjykimit të shkallës së parë, përkundrazi, në zbatim të nenit 465 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, ajo ka përsëritur hetimin gjyqësor, duke gjykuar si gjykatë e shkallës së parë.

Kolegji civil i Gjykatës së Lartë që e ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e kërkuesit në të cilin janë parashtruar pothuajse po ato shkaqe të përmendura në Gjykatën e Apelit, ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se rekursi i paraqitur nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rekursin drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka parashtruar se vendimet gjyqësore mbështeten në akt-ekspertime kontradiktore e të falsifikuara dhe se çmimi i truallit është llogaritur me 1600 lekë m² kur ky çmim duhej llogaritur me 330 lekë m². Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 09.02.2000 ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar me nenin 5 të ligjit nr.8431, datë 14.12.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”.

Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar në tërësi shkaqet e parashtruara në kërkesën e kërkuesit Skënder Roqi, arrin në përfundimin se në rastin konkret nuk ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës. Sikurse rezulton nga përmbajtja e rekursit drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të janë parashtruar vetëm argumente që kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe në këto rrethana, vendimi i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, duke qenë i bazuar në ligj, nuk ka shkak që të deklarohej antikushtetues. Edhe në vetë kërkesën e kërkuesit nuk përmendet asnjë argument për antikushtetutshmërinë e këtij vendimi. Që të shfuqizohet si antikushtetues të gjithë vendimet e atakuara nga kërkuesi ishte e domosdoshme që shkeljet e pretenduara të ishin ngritur në të gjitha instancat gjyqësore dhe në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet të paraqiten argumente të karakterit antikushtetues për secilin vendim që kërkohet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 08.11.2000
Nr.66 i Regj.Themeltar.
Nr.76 i Vendimit.

V E N D I M
“NE EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Kujtim Puto,	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 17.10.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.65 Akti që i përket:

KËRKUES: AVOKAT SPIRO KASSO

O B J E K T I

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.138, datë 26.11.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi në kërkesë dhe në seancë gjyqësore ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të mësipërme:

1. Vendimet bien ndesh me parimet e Kushtetutës dhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për të drejtat e mbrojtësit në gjykimin penal. Mbrojtësi i të pandehurit të gjykuar në mungesë gëzon të gjitha të drejtat, pra edhe të drejtën e ankimit;

2. Avokati ka qenë pajisur me prokurë të posaçme nga familjarët e të pandehurit për të bërë ankim dhe kjo ka vlerë juridike njëloj me prokurën e të pandehurit;

3. Gjykata e Apelit dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, nuk kanë vlerësuar as prokurën e lëshuar nga vetë i pandehuri pas ankimit të bërë nga avokati e para gjykimit në Gjykatën e Apelit. Me këtë prokurë, ai miraton ankimin e bërë nga avokati.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji shpjegimet e kërkuesit, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Gjykata e Rrethit Fier, me vendimin nr.197, datë 04.10.1999 ka deklaruar fajtor të pandehurin Klodian Rushi për veprën penale të parashikuar nga nenet 76-23, 278/2 dhe 323/1-50/gj të Kodit Penal dhe duke bërë bashkimin e krimeve e ka dënuar me 8 (tetë) vjet burgim. I pandehuri është gjykuar në mungesë dhe është mbrojtur nga avokati Kujtim Sina. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.138, datë 26.11.1999, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga avokati Spiro Kasso, me arsyetimin se kur u paraqit në gjykatë ankimi, nuk ka qenë i pajisur me aktpërfaqësimi të lëshuar në formën e parashikuar nga ligji, pra me prokurë të lëshuar nga vetë i pandehuri. Këtë vendim e ka lënë në fuqi kolegji penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.93, datë 24.03.2000.

Avokati Spiro Kasso, ka bërë ankim brenda afatit ligjor kundër vendimit të dënimit të Gjykatës së Rrethit Fier. Për këtë, ai ka qenë i pajisur me prokurë të lëshuar nga i ati i të pandehurit. Prokura e familjarëve të të pandehurit të gjykuar në mungesë, është një aktpërfaqësimi i vlefshëm për ankim në kuptim të nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale. Ajo është lëshuar në formën e parashikuar nga ligji, sepse neni 48 i Kodit të Procedurës Penale, lejon që zgjedhja e mbrojtësit për

personin e dënuar me burgim, të bëhet edhe nga një i afërm i tij me akt të dhënë mbrojtësit. Duke mos i pranuar ankimin, Gjykata e Apelit Vlorë dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, kanë cënuar të drejtën themelore të mbrojtjes dhe të ankimit të parashikuara nga nenet 31 e 43 të Kushtetutës dhe njëkohësisht kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, sepse i pandehuri nuk ka realizuar dot as të drejtën e ankimit dhe as atë të mbrojtjes. Ky qëndrim, vjen në kundërshtim gjithashtu edhe me kërkesat e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, me nenin 2/1 të Protokollit nr.7 të kësaj konvente dhe nenin 14/5 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Përsa sipër dhe duke rikonfirmuar qëndrimin tonë mbajtur në vendimet nr.17, datë 07.04.2000 e nr.48, datë 28.07.2000, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimi i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohen si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.138, datë 26.11.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 08.11.2000
Nr.65 i Regj.Themeltar.
Nr.77 i Vendimit.

MENDIMI I PAKICES

Jemi kundër vendimit të shumicës që ka shfuqizuar si antikushtetues vendimet nr.138, datë 26.1.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.93, datë 24.03.2000 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, për këto arsye:

Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur nga avokati Spiro Kasso. Sipas neneve 28 gërma “e” dhe 29 gërma “a” të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet me nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij. Në rastin konkret, i dënuari nuk e ka nënshkruar vetë kërkesën dhe as që ka caktuar përfaqësues me-akt përfaqësimi. Kështu, përderisa kërkesës nuk i është bashkëlidhur akti i përfaqësimit, sipas gërmës “a” të nenit 29 të ligjit të sipërcituar, avokati Spiro Kasso nuk mund të vejë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Rregullat e mësipërme i ka vendosur vetë ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, prandaj nuk mund të zbatohen rregulla të tjera që vijnë ndesh me këtë ligj. Kjo është një nga arsyet që kërkesa nuk duhej pranuar.

Gjithashtu, në vështrim të dispozitave procedurale penale, vendimi i shumicës, sipas mendimit tonë, në themel nuk është i drejtë, sepse sipas nenit 50 të Kodit të Procedurës Penale, ankimi është një e drejtë që i rezervohet vetëm të pandehurit dhe për rrjedhojë, pa pëlqim të tij të dhënë në formën e parashikuar në ligj, nuk ka të drejtë të ushtrojë ankim të afërmit ose persona të autorizuar prej tyre. Për më tepër, neni 410 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale thekson se për gjykimin në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në formën e parashikuar nga ligji. Sikurse rezulton nga dosja, i pandehuri nëpërmjet një prokure të

hartuar në Gjyrokastër ka autorizuar avokatin që ta përfaqësojë në Gjykatën e Apelit. Kjo do të thotë që i pandehuri i ka pasur mundësitë të caktojë përfaqësues për t'u përfaqësuar në të gjitha instancat gjyqësore, ashtu edhe për t'u përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese.

Mosrespektimi i këtyre normave ligjore si përsa i përket paraqitjes së kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ashtu edhe për përfaqësimin në instancat ligjore, e bëjnë vendimin e shumicës të pambështetur në ligj.

ANËTARË
K. Puto, H. Fuga

K Ë R K E S Ë (PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Kërkuese: Shqiponja Mustafa e bija e Gjyshit e datëlindjes 1944, banuese në Vlorë.

Objekti: Shpallja të vdekur të bashkëshortit tim Sadik Mustafa në bazë të neneve 19 të Kodit Civil, neni 375 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

Parashtroj se jam bashkëshortja e të quajturit Sadik Mustafa, i cili më datë 9.10.1993 duke udhëtuar nga Italia për në Shqipëri me anijen "Jon" është zhdukur dhe që nga ajo kohë nuk kemi asnjë lajm për të.

Duke qenë se nga rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja del se bashkëshorti im ka vdekur aksidentalisht, kërkoj që të shpallet i vdekur.

KËRKUESJA
Shqiponja Mustafa

VENDIM I SHKURTUAR (PËR SHPALLJE TË VDEKUR)

Gjykata e rrethit Vlorë, konform nenit 306, 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, 75 e vijues të Kodit Civil vendosi shpalljen të vdekur të Sadik Mustafës.

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.29 në faqen 2 të përmbajtjes, titulli i Vendimit të KM nr.493, datë 19.9.2000, të bëhet: "Për mënyrën e shpërndarjes dhe të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë", dhe titulli i Vendimit të KM nr.494, datë 19.9.2000, të bëhet: "Për një shtesë në vendimin nr.400, datë 27.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e privatizimit të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë".

Në Fletoren Zyrtare me nr.31 në faqen 2 të përmbajtjes, Kërkesa për shpallje të vdekur të Lami Dudës të bëhet Sokol Bidës.

Në Fletoren Zyrtare me nr.32 në faqen 3 të përmbajtjes, Vendimi i KM nr.39, datë 7.10.2000, të bëhet Vendim i KQZ nr.39, datë 7.10.2000.

Në faqen 1602 (për arsye teknike), në Vendimin nr.30 të KQZ datë 7.10.2000, në paragrafin e pestë, rreshti i dytë, në vend të nenit CAPut!’, të bëhet neni 19.

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 30.11.2000
Doli nga shtypi më 1.12.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë